



Key Action 1
– Mobility for learners and staff –

**Hapet thirrja për mobilitete stafi të UPT-së,
në kuadër të Programit Erasmus+ KA107
në University of Kassel, Gjermani.**

Në kuadër bashkëpunimit midis Universitetit Politeknik të Tiranës dhe University of Kassel, publikohet thirrja për mobilitete për staf të Universitetit Politeknik të Tiranës, në University of Kassel (uni-kassel.de/go/radverkehr).

Lloji i mobilitetit përfshin: Pjesëmarrje në “Shkollën Ndërkombëtare të Vjeshtës për Mobilitetin e Qëndrueshëm – made in Kassel”, (“*MoveOn International Autumn School on Sustainable Mobility - made in Kassel*”).

Fusha e mobilitetit: Staf akademik dhe/ose PhD student nga Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit – Infrastrukturë Transporti dhe Fakulteti i Arkitekturës dhe Urbanistikës – Planifikimi Urban.

Kushtet për pjesëmarrje:

- Të ketë një background në profilin e transportit apo fusha të lidhura me planifikimin urban;
- Të ketë përvojë në të shkruar akademike dhe kërkim shkencor.

Numri total i stafit: 3 (Në vartësi të konfirmimit nga zyra e marrëdhënieve ndërkombëtare e Universitetit Kassel.)

Koha e kryerjes së mobilitetit, në Universitetin Kassel: 21 – 25 tetor 2025

Financimi Erasmus+ do të mbulojë kostot e udhëtimit dhe akomodimit.

Programi përbëhet nga tre pjesë:

- 15 tetor: Sesion hyrës - online
- **21–25 tetor: Programi në vend, në Universitetin e Kassel-it, Gjermani**
- 10 nëntor: Sesion përmbyllës - online

Dokumentat e nevojshme për aplikim për stafin akademik/administrativ:

- CV + lista e publikimeve (në gjuhën angleze);
- Letër motivimi;
- Kopje e Pasaportës;
- Aproxim nga përgjegjësi i njësisë bazë dhe nga përgjegjësi i njësisë kryesore, ku aplikanti bën pjesë, në lidhje me planin e mobilitetit dhe periudhën, të parashikuara për t’u kryer në universitetin pritës*;
- Dokumenti Mobility Agreement (Staff Mobility for Training) për stafin, në universitetin pritës**.

**Plani i mobilitetit dhe periudha e propozuar e mobilitetit duhet të aprovohet/firmoset paraprakisht nga përgjegjësi i njësisë bazë dhe nga përgjegjësi i njësisë kryesore ku aplikanti bën pjesë.*

*** Mobility Agreement for Training për stafin është një dokument në të cilin duhet të specifikohet programi juaj i propozuar që do të kryeni gjatë periudhës së shkëmbimit, i cili është aprovuar paraprakisht nga përgjegjësi i njësisë bazë, sipas pikës më sipër. Kjo është formë standarde e Erasmus+ dhe firmoset nga aplikanti dhe personi përgjegjës për mobilitetet në Universitetin Politeknik të Tiranës, i cili është Zv.Rektori për Anën Shkencore dhe Marrëdhëniet me Jashtë.*

Afati për aplikim, pranë Drejtorisë së Komunikimit dhe Koordinimit në UPT: 18 gusht 2025, ora 12.00.

Pas përfundimit të mobilitetit, personi pjesëmarrës në Universitetin Kassel, duhet të dorëzojë një raport te departamenti përkatës dhe te Drejtoria e Komunikimit dhe Koordinimit, lidhur me aktivitetin.

Për informacione shtesë në lidhje me procesin e aplikimit në UPT dhe për sigurimin e materialeve informuese për UPT–në në këtë aktivitet, ju lutemi kontaktoni në email: abego@upt.al , rkodra@upt.al